



**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**

01-Nr- 016-10161

Më datë 16.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-182 për mbrojtjen nga dhuna në familje "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-7/2010" dhe nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016" Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Për formimin këshillit-mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje

1. Me qëllim të ofrimit të sigurisë, parandalimin, trajtimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e rasteve të dhunës në familje, formohet këshilli-mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje në këtë përbërje:
  - 1.1 Bali MUHARREMAJ-----Kryetar i Komunës
  - 1.2 Selajdin GALLAPENI-----Kryetar i Gjykatës Themelore dega në Suharekë
  - 1.3 Mehreme HOXHA-----Prokurore në Prokurorin Themelore në Prizren
  - 1.4 Afrim SYLAJ-----Komandant i stacionit Policor në Suharekë
  - 1.5 Avni BYTYÇI-----Koordinator i KKSB-së
  - 1.6 Ali AHMETI-----Mbrojtës i viktimave
  - 1.7 Veton HALILI-----Zyra për ndihma juridike falas
  - 1.8 Habibe BYTYQI-----Zyrtare për barazi gjinore
  - 1.9 Besa KUQI-----Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
  - 1.10 Sale BYTYQI-----Drejtor i QKMF-së
  - 1.11 Sami RRAKAQI-----Drejtor i qendrës për punë sociale
  - 1.12 Remzi BAJSELMANI-----Drejtor i Arsimit
  - 1.13 Teuta GASHI-----Policia e Kosovës
  - 1.14 Mehreme Hoxha-----Zyra komunale për punësim
  - 1.15 Julibea KABASHI-----Përfaqësuese e Strehimores në Prizren
  - 1.16 Sanie KUQI-REXHEPAJ---Përfaqësuese e grupit të grave
2. Koordinator e këshillit-mekanizmit kundër dhunës në familje sipas detyrës zyrtare, emërohet **znj. Habibe Bytyqi**.
3. Detyrat e këshillit-mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje janë të përcaktuar me Ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe në bazë të marrëveshjes të mirëkuptimit të nënshkruar në mes të institucioneve kompetente.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe marrëveshja e mirëkuptimit të nënshkruar nga institucionet kompetente e që është e zbatueshme në Komunën e Suharekës.
5. Ky vendi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës në Suharekë dhe e shfuqizon vendimin me numër 01-Nr-016-73732 të datës 29.10.2019.

**Kryetari i Komunës**

**Bali MUHARREMAJ**

